



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË - DEGA E GJYKATËS DEÇAN

---

Numri i lëndës: 2022:254948

Datë: 19.12.2023

Numri i dokumentit: 05089115

C.nr.1029/22

GJYKATA THEMELORE NË PEJË, Dega në Deçan, Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtari Bajram Cacaj, në çështjen juridike Kontestimore të paditësit F.C. nga Komuna e Deçanit, të cilin me autorizim e përfaqëson G.D. avokate në Deçan, kundër të paditurës Komuna e Deçanit, Drejtoria Komunale e Arsimit, me seli në Deçan, të cilën e përfaqëson D.P. Avokat Publik Komunal, në çështjen juridike kompensim mbi bazën e përqindjes së inflacionit, me vlerë të kontestit 529,77 €, jashtë seancës, më datë 19.12.2023 mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET pjesërisht e bazuar kërkesëpadia e paditësit F.C. dhe DETYROHET e paditura Komuna e Deçanit, Drejtoria Komunale e Arsimit, që paditësit t'ia paguaj në emër të pagesës shtesë - përqindjes së inflacionit shumën prej 480,28 euro, shumë kjo e cila i referohet periudhave si në vijim:

- për muajin dhjetor 2019 shumën prej 7,08 euro;
- periudhën janar-dhjetor 2020 shumën prej 6,46 euro;
- për periudhën janar-dhjetor 2021 shumën prej 110,10 euro;
- për periudhën janar-nëntor 2022 shume prej 356,04 euro,

të gjitha me kamatë ligjore prej 8% nga data 02.12.2022 (data e paraqitjes se padisë) deri në pagesën definitive si dhe shpenzimet e procedurës në shumë të përgjithshme prej 124.00 euro, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarrimit.

II. REFUZOHET pjesa tjetër e kërkesëpadisë mbi shumën e gjykuar si në pikën I të këtij aktgjykimi dhe atë në shumë prej 49,49 euro, si e pabazuar.

A r s y e t i m

Paditësi përmes të autorizuarës të tij në padinë e parashtruar në gjykatë me datë 02.12.2022, si dhe parashtrësën për precizimin e padisë të datës 16.10.2020, ndër të tjera ka theksuar se paditësi është punëtor i arsimit, konkretisht punëtor teknik pranë Gjimnazit “Vëllezërit Frashëri”, në Deçan dhe meqenëse në vendin tonë gjatë kohë ka pasur inflacion ekonomik dhe në bazë të nenit 35 paragrafi 10 të Kontratave Kolektive të Arsimit në Kosovë është garantuar e drejta e kompensimit të shtesës në pagë në lartësinë e përqindjes së inflacionit në vend dhe meqenëse e paditura nuk ka vepruar sipas Kontratës Kolektive nga ku rrjedhë kjo e drejtë e paditësit ka kërkuar nga gjykata që ta aprovoj kërkesëpadinë e paditësit në tërësi të bazuar, duke e detyruar të paditurën që paditësit t’ia kompensoj shtesën në pagë në emër të inflacionit sikurse në parashtrësën për precizimin, së bashku edhe me kamatën ligjore, si dhe i ka kërkuar shpenzimet e procedurës.

E paditura përmes përfaqësuesit të saj me përgjigje në padi e ka kontestuar pjesërisht padinë dhe kërkesë padinë e paditësit dhe i ka propozuar gjykatës që të njëjtën pjesërisht ta refuzoj si të pabazuar për shkak të jashtë afatshmërisë dhe parashkrimit të pjesshëm, ka shtuar se së pari paditësi nuk e ka shtjerr procedurën administrative për realizimin e të drejtës së pretenduar, por ka shkuar drejtpërdrejtë me padi në gjykatë, paditësi kërkesën e vetë e bazon në Kontratën Kolektive të Arsimit në Kosovë të 22.01.2021, por i njëjti të drejtën e kërkon nga viti 2019 deri 2022, mirëpo kontrata nuk ka efekt retroaktiv që do të thotë se nga 2019 deri në momentin e nxjerrjes së kontratës së re të vitit 2021 paditësit nuk i takon përqindja e inflacionit, është e vërtetë se ka ekzistuar edhe një kontratë e arsimit e vitit 2017 e cila tani nuk është në fuqi dhe për njohjen e të drejtës në bazë të saj kemi parashkrim sepse neni 87 i Ligjit të Punës parasheh që të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para parashkruhen në afat prej 3 vitesh kurse në rastin konkret padia është bërë 5 vite pas nxjerrjes së kontratës kolektive të vitit 2017, andaj ka propozuar që gjykata pjesërisht të refuzoj padinë e paditësit kurse nga momenti i nxjerrjes së kontratës kolektive të vitit 2021 e deri në vitin 2022 t’i njihet e drejta në inflacion.

Gjykata pas shqyrtimit të padisë, provave që gjenden në shkresat e lëndës, precizimit të padisë, si dhe përgjigjes në padi të paraqitur nga ana e të paditurës, në kuptim të nenit 8 lidhur me nenin 398 dhe 399 të LPK-së, gjeti se janë plotësuar kushtet për dhënien e aktgjykimit jashtë seance dhe erdhi në përfundim se kërkesëpadia e paditësit është pjesërisht e themeltë dhe si e tillë pjesërisht u aprovua.

Nga parashtrimet e palëve ndërgjyqëse të paraqitura me padi, precizim të padisë dhe përgjigjes në padi, gjykata ka gjetur se nga Kontrata e punës për paditësin e lëshuar nga Komuna e Deçanit, Drejtorati për Arsim, këtu e paditura, vërtetohet fakti se paditësi është në marrëdhënie pune tek e paditura në shkollën “Vëllezërit Frashëri” në Deçan, si punëtor teknik. Bazuar në Listën e pagave të lëshuar nga Buxheti i Republikës së Kosovës vërtetohet se lartësia e pagës bazë të paditësit është shuma prej 262,25 €. Po ashtu, gjykata bazuar në Indeksën e Harmonizuar të Çmimeve të Konsumit i publikuar nga Agjencia e Statistikave të Kosovës, ka vërtetuar se shkalla e inflacionit për vitin 2019 ka qenë 2.7%, për vitin 2020 ka qenë 0.2%, për vitin 2021 ka qenë 3.4%, ndërsa për vitin 2022 ka qenë 11.6%. Provave të lartcekura gjykata iu fali besimin e plotë

ngase është bërë e besueshme fuqia provuese e tyre, duke u bazuar edhe në nenin 329 par.1 të LPK-së, i cili përcakton se: *“Shkresa të cilën e ka hartuar në formën e caktuar organi shtetëror brenda kufijve të kompetencës së vet, si dhe shkresa të cilën në formë të tillë e ka hartuar ndërmarrja apo organizata tjetër në ushtrimin e autorizimeve publike që i janë besuar me ligj (dokumenti publik), provon saktësinë e asaj që konfirmohet apo caktohet në të”*.

Gjykata gjen se në rastin në fjalë duhet të zbatohen dispozitat e Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë (KKAK), të nënshkruar në mes të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Kulturës, e cila ka hyrë në fuqi me datë 18.04.2017 dhe asaj të datës 22.01.2021 e cila ka qenë në fuqi deri me datë 21.11.2022, ku në mënyrë identike në nenin 35 par.10 kanë përcaktuar se *“Për çdo vit të përcillet shkalla e inflacionit sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës dhe përqindja (%) e inflacionit të futet në pagë”*, ashtu që gjykata erdhi në përfundim se në rastin konkret paditësit i takon e drejta në pagesën mbi bazën e përqindjes së inflacionit, si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi, pasi që një dispozitë e tillë është e karakterit imperativ dhe si e tillë do të duhej që shkalla e inflacionit të llogaritet në pagë, marrë parasysh që nga lista e pagave që gjendet në shkresat e lëndës, nuk rezulton që një pagesë e tillë është kryer nga e paditura.

Sa i përket lartësisë së kërkesëpadisë, gjykata vendosi duke pasur parasysh të dhënat e nxjerra nga Enti i Statistikave të Kosovës sa i përket shkallës mesatare vjetore të inflacionit, përkatësisht ngritjen zingjiror të inflacionit ndër vite dhe atë duke filluar llogaritjen nga viti 2019 deri në vitin 2022 (brenda kërkesës nga periudha e aprovuar) sipas përlllogaritjes si në vijim:

- Për muajin dhjetor 2019, gjykata pati parasysh që shkalla e inflacionit ka qenë 2.7%, andaj duke llogaritur në pagën bazë të paditësit e cila në vitin 2019 ka qenë 262.25 euro, i bie që shuma e inflacionit që dashur të futej në pagën bazë për muajin dhjetor është 7,08 euro ( $262,25 * 2,7\% * 1 = 7,08$ );

- Për periudhën janar-dhjetor 2020, gjykata pati parasysh që shkalla e inflacionit ka qenë 0.2%, andaj duke e llogaritur në pagën bazë të paditësit sipas shtimit dinarik e cila në vitin 2020 do të duhet të ishte 269.33 euro, atëherë i bie që shuma e inflacionit që është dashur të futej në pagën bazë për periudhën 12 mujore në total të jetë 6,46 euro, apo 0.53 euro për çdo muaj ( $269,33 * 0,2\% * 12 = 6,46$ );

- Për periudhën janar-dhjetor 2021, gjykata pati parasysh që shkalla e inflacionit ka qenë 3.4%, andaj duke e llogaritur pagën e paditësit sipas shtimit dinarik e cila në vitin 2021 do të duhej të ishte 269.86 euro, atëherë i bie që shuma e inflacionit që është dashur të futej në pagën bazë për periudhën 12 mujore në total të jetë 110.10 euro, apo 9.17 euro për muaj ( $269,86 * 3,4\% * 12 = 110,10$ ) dhe

- Për periudhën janar-nëntor 2022, gjykata pati parasysh që shkalla e inflacionit ka qenë 11.6%, andaj duke e llogaritur pagën e paditësit sipas shtimit dinarik e cila në vitin 2022 do të duhej të ishte 279,03 euro, atëherë i bie që shuma e inflacionit që është dashur të futej në pagën bazë për

periudhën 11 mujore në total të jetë 356,04 euro, apo 32.36 euro për muaj (279,03\*11.6%\*11=356,04).

Duke qenë se mes palëve nuk është kontestuese gjendja faktike përkatësisht se paditësja është e punësuar tek e paditura dhe se në periudhën nga data 02.12.2019 deri me datë 30.11.2022 në pagën e paditësit nuk është përfshirë edhe shkalla e caktuar e inflacionit, të cilat fakte nuk i ka kontestuar as e paditura në përgjigjen në padi, edhe përkundër faktit se e njëjta e ka kundërshtuar pjesërisht kërkesëpadinë, gjykata erdhi në përfundim se janë plotësuar kushtet për dhënien e aktgjykimit jashtë seance konform nenit 398 të LPK ku parashihet që *“Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike, dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritor, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund ta jep aktgjykimin me të cilën e pranon si të themeltë kërkesëpadinë”*, për çka vendosi si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Sa i përket pretendimit të dhënë në përgjigje në padi se paditësi nuk ka shterur mjetet juridike, gjykata vlerësoj se nuk qëndron ky pretendim, për faktin se paditësi si i punësuar në arsim, nuk ka qenë i detyruar që të bëjë kërkesë të veçantë për kompensim për shkak të kualifikimit, pasi të njëjtën punëdhënësi do të duhej ta përmbushte në momentin që janë plotësuar kushtet për kompensim, prandaj meqë një detyrim i tillë nuk është përmbushur, ka lindur e drejta për të kërkuar kompensimin përmes rrugëve gjyqësore, siç ka vepruar në rastin konkret paditësi.

Gjykata vlerësoi pretendimin e të paditurës në lidhje me mungesën e bazës ligjore të kërkesëpadisë deri në momentin e nxjerrjes së Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të vitit 2021, mirëpo këtë pretendim e refuzoi për shkak se baza e kërkesëpadisë për periudhën kohore para vitit 2021 rrjedh nga Kontrata Kolektive e Arsimit në Kosovë e datës 18.04.2017, e cila aplikohet për periudhën kohore nga data 18.04.2017 e deri më datën 21.01.2021.

Sa i përket pjesës refuzuese respektivisht shumë në lartësi prej 49,49 euro gjykata të njëjtën e refuzoi për shkak se pretendimet e përfaqësuesit ligjore të të paditurës në lidhje me parashkrimin e kërkesës, gjykata i morri pjesërisht si të bazuara dhe atë vetëm sa i përket periudhës kohore janar – nëntor të vitit 2019, pasi që nga provat që gjenden në shkresat e lëndës vërtetohet se paditësi kërkesën e tij për kompensimin të përqindjes shtesë në emër të inflacionit për periudhën e lartcekur e ka parashtruar pas afatit kohor prej 3 (tre) viteve siç parasheh neni 87 i Ligjit Nr.03/L-212 të Punës, i cili ka përcaktuar që *“Të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej tri (3) vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës”*, andaj në rastin konkret padia për këtë periudhë kohore është parashtruar me datë 02.12.2022 që nënkupton më shumë se tri vite nga lindja e të drejtës për kërkesën nga marrëdhënia e punës, përkatësisht lidhur me kompensimin e të ardhurave nga marrëdhënia e punës mbi bazën e përqindjes së inflacionit, për çka gjykata vendosi si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi, duke pasur parasysh se edhe në rastin konkret janë plotësuar kushtet ligjore për marrjen e aktgjykimit jashtë seancës të përcaktuara në nenin 399 të LPK, ku në paragrafin 1 të këtij neni është përcaktuar se *“Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se nga faktet e treguara në padi nuk del themelësia e kërkesëpadisë, atëherë ajo do të jep vendimin meritor me të cilin refuzohet si e*

*pathemeltë kërkesëpadia”, ndërsa në paragrafin 2 është paraparë se “Kërkesëpadia është e pathemeltë, në vështrim të paragrafit 1 të këtij neni, po që se qartazi është në kundërtënie me faktet e treguara në padi, apo, po që se faktet mbi të cilat mbështetët kërkesëpadia qartazi janë në kundërtënie me provat të cilat i ka propozuar paditësi, apo me faktet që janë botërisht të ditura”.*

Lartësia e kamatës së përcaktuar prej 8%, i referohet nenit 382 të LMD-së dhe kamata është llogaritur nga dita e parashtrimit të padisë.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale, gjykata e morri sipas nenit 449 dhe 452 par. 2 të LPK, duke pasur parasysh suksesin në procedurë, me ç’rast paditëses iu pranua shuma e shpenzimeve në vlerë prej 124.00€. Lartësia e shpenzimeve të aprovuara i referohet shpenzimeve për pagesën e taksës gjyqësore në vlerë prej 20,00 euro, si dhe për përpilimin e padisë shuma prej 104,00 euro.

Nga të lartcekurat, gjykata bazuar në nenin 143 lidhur me nenin 398 dhe 399 të LPK, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

#### GJYKATA THEMELORE PEJË

Dega në Deçan

Departamenti i Përgjithshëm

C.nr.1029/22, më 19.12.2023

Gjyqtar

---

Bajram Cacaj

#### KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 7 ditësh, nga dita e marrjes në dorëzim, Gjykatës së Apelit të Kosovës, përmes kësaj gjykate.

Ankesa duhet të paraqitet në ekzemplarë të mjaftueshëm për palët dhe gjykatën.